

Aplikim për Programin

“Master i Shkencave në Menaxhim Risku” (120 kredite)

Përshkrimi i programit

Masteri i Shkencave në Menaxhim Risku është program studimi dy vjeçar. Programi Master i Shkencave në Menaxhimin e Riskut ofrohet nga Departamenti i Financës, për herë të parë, përgjatë vitit akademik 2018-2019.

Ky program është hartuar në kuadër të projektit K- Force (Knowledge for a resilient society), projekt ky i financuar nga Komuniteti Evropian dhe i zhvilluar në kuadër të programit Erasmus +. Ky programi i ri master synon të gërshetojë njohuritë në tre drejtime të menaxhimit të riskut: menaxhimi i riskut të ndërmarrjes; menaxhimi i riskut financiar si edhe menaxhimi i riskut të katastrofave.

Në hartimin e kurrikulës së këtij programi është zhvilluar një proces konsultimi i gjerë jo vetëm me partnerët e projektit K-Force, por edhe me ekspertë të institucioneve më të rëndësishme të fushës së menaxhimit të riskut financiar, menaxhimit të katastrofave dhe përfaqësues të rëndësishëm të fushës së kërkimit në Shqipëri.

Ky program do të ofrojë një sistem të gjerë njohurish në financë dhe specifikisht në fushën e menaxhimit të riskut, me objektiv kryesor formimin e specialistëve të aftë për ushtrimin e profesionit të analistit të riskut në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Kurrikula e programit synon të përgatisë studentin me të gjitha aftësitë e nevojshme si analist risku me një nivel të lartë njohurish shkencore teorike dhe njohuri praktike, si dhe orfron njohuri të thelluara në drejtim të analizave sasiore. Një diplomë e tillë do t’iu mundësojë studentëve të diplomuar në këtë program studimi punësimin në institucione në nivel qendror dhe lokal, institucione kërkimore-shkencore, institucione financiare, ente, kompani (publike apo private), shoqata të ndryshme, etj, si specialist i fushës përkatëse të studimit apo në rolin e menaxherit të riskut. Gjithashtu përfundimi me sukses i këtij programi studimi, u mundëson studentëve ndjekjen në mënyrë koherente të një karriere kërkimore apo akademike nëpërmjet vazhdimin të studimeve të doktoraturës, duke rritur kështu mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të karrierës së tyre profesionale.

Në vitet e para të tij, ky program master do të ofrohet në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë dhe studentëve do t’u ofrohet mundësia për zhvillimin e shkëmbimeve në universitete të Ballkanit Perëndimor për një periudhë një-semestrale. Njëkohësisht, lëndë të ndryshme do të funksionojnë mbi bazën e konceptit të leksioneve të përbashkëta dhe do të ofrohen në bashkëpunim me partnerët e projektit dhe me ekspertë të tjerë të fushës që ushtrojnë profesionin e tyre në institucione të rëndësishme financiare në Shqipëri. Ndër universitetet

partnere, me të cilat do të bashkëpunohet për ofrimin e këtij programi përfshihen Unviersiteti i Lundit (Suedi), Universiteti i Aalborgut dhe Universiteti Teknik i Danimarkës (Danimarkë), Universitetin i Zilinës (Sllovakia), Universitetin i Shkupit (Maqedoni), Universiteti i Novi Sad-it dhe Shkolla e Lartë Teknike e Novi Sadit (Serbi), Universiteti i Banja Lukës dhe Universiteti i Tuzlës (Bosnje-Herzegovinë) dhe Universitetin Epoka (Shqipëri).

Ndër institucionet e tjera me të cilat do të bashkëpunohet për zhvillimin dhe organizimin e programit të lëndëve të ndryshme përfshihen: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Programi i Ndryshimeve Klimatike në PNUD, Qendra Rajonale e Mjedisit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Bujqësisë, etj.

Plani mësimor i programit

- Bazat e Vlerësimit të Riskut dhe Vendimmarrja
- Menaxhimi i Riskut të Ndërmarrjes
- Ekonometri
- Parashikimi dhe Vlerësimi Financiar
- Menaxhimi i Riskut në Banka
- Metoda Kërkimi
- Menaxhimi i Riskut të Katastrofave
- Probabiliteti në Menaxhimin e Riskut
- Menaxhimi i Riskut dhe Sigurimet
- Ekonomiks Zhvillimi
- Auditim me Bazë Risku
- Modelimi i Riskut në Praktikë
- **Lëndë me zgjedhje** (studenti zgjedh 3 lëndë nga 6)
 - Menaxhimi i Riskut në Sistemet e Informacionit
 - Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike
 - Tregjet e Energjisë
 - Logjistikë dhe Menaxhim Operacionesh
 - Vlerësimi Pasurive të Paluajtshme
 - Siguria dhe Shëndeti në Punë
 - Praktika
 - Mikroteza

Procesi i aplikimit

Aplikimet do të kryhen nga data 27 shtator deri në 12 tetor 2018, pranë Sekretarisë Mësimore, të Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (FEUT).

Kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit “Master i Shkencave në Menaxhim Risku” (MSHMRI):

- Të gjithë studentët që kanë mbaruar studimet universitare në FEUT që kanë të paktën një diplomë bachelor në degën Financë.
- Të gjithë studentët që kanë mbaruar studimet universitare në FEUT që kanë të paktën një diplomë bachelor në degën Administrim Biznes.
- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në degën Ekonomiks të FEUT.
- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në degën Informatikë Ekonomike të FEUT.
- Të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor në Financë-Kontabilitet, Administrim Biznesi ose Ekonomiks në Fakultete të tjera të Ekonomisë (publike/ jopublike –vendase/ të huaja) mund të pranohen pasi të jetë kryer njohja e diplomave të tyre sipas rregullave përkatëse.

Aplikanti duhet të zotërojë të paktën në nivelin B1 (të vërtetuar me dokumentin përkatës) një nga gjuhët e huaja të vendeve të Bashkimit Europian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).

Shënim: Studentët fitues në këtë program do të përzgjidhen mbi bazën e mesatares së arritur në studimet e ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe preferencave të mësipërme.

Tarifa e shkollimit

Studentët fitues në këtë program studimi do të paguajnë tarifën e shkollimit për studimet master vetëm për vitin e dytë të studimeve.